**REPUBLIKA E SHQIPERISË**
**BASHKIA VLORË**
**NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Nr______Prot                                                            Vlorë, më___.___2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“NSHP, Sinjalistikë, Tabela, Tubo, Polica të Shtrirë,Parapeta Metalike, Kone ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (**CPV**):
**34992200-9**
**VLERA** E FONDIT LIMIT: **2,500,000 ( dy milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Vlorë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi**: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*Specifikat ekonomike:*

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros minimale vjetore, duhet të jetë *jo më e vogël se 40%* e *vlerës së përllogaritur të kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

**2,500,000 x0.4 = 1,000,000 ( një milion) lekë pa tvsh**

---

***Argumentimi:*** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, *nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.*

***Argumentimi:*** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore"*

**2.2.3.** Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës (*sipas nenit 83 te Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020)* është 2% e fondit limit ose 50,000 ( pesëdhjetë mijë) lekë Pa TVSH.

**2.2.4** Vërtetim të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2024 në të gjitha adresat ku operatorët ekonomik kanë ushtruar aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së

*Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas késteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë*

*detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

**<u>2.3 Kapaciteti teknik:</u>**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,

**b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

***Argumentimi**: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

**<u>2,500,000x0.2=500,000 ( pesëqind mijë) lekë pa TVSH.</u>**

**2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:** Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

***Argumentimi**: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të domosdoshme në realizimin e shërbimeve objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi kemi të bëjmë me pajisje speciale të cilat domososhmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre në kryerjen e punimeve të ndryshme specifike*

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet te paraqese autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i autorizuar per mallrat e ofertuara ku te percaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose te distributorit te autorizuar. Ne rast

se do te paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar duhet te vertetohet lidhje midis distributorit te autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

*Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është nje dokument i rëndësishëm, pasi përvecse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.*

*Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftesitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.*

*Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie (të vlefshme) të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akredimit në Shqipëri (DPA), si më poshtë:

- □ ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente të tij.
- □ ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit Mjedisor) ose ekuivalente të tij.

Çertifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyera dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj. Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat ISO sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

**Argumentimi**: Kriteret për paraqitjen e ISO-ve sa më sipërcituar u vendosën në përputhje me *parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë", ku percaktohet se këto Çertifikata duhet të jenë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për te realizuar kontratën. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë certifikimet e nevojshme të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për realizimin e objektit të kontratës.*

*ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.*
*Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së .*
*Për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si çertifikata ISO e cila është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.*

**Argumentimi**:*ISO 14001 specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqendrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundësuar atë për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim :*

- *Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;*
- *Vlerësimit të aspekteve mjedisore;*
- *Përmirësimin e performancës mjedisore;*
- *Respektimin e ligjeve;*
- *Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;*
- *Përmirësimin e imazhit të kompanisë;*
- *Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.*

**2.3.5** Operatori ekonomik te paraqese mostra për të gjithë artikujt e prokuruar ditën dhe orën e hapjes së tenderit për të verifikuar nëse mostrat përputhen me specifikimet teknike.

***Argumentimi:*** *Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 40, pika 6, gërma a) ku cilësohet se: Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata*

*në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*
*Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi*

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallrave objekt prokurimi.

Sa më sipër mjeti nevojitet të jetë i pajisur me :

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të cilin fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huaje.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

a) Kontratë qiraje.

b) Leje qarkullimi e mjetit.

c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

ç) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

***Argumentim**: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1. ...........................................................................................................................................**
**...................................................................................................................................**

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

**II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* ***duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar****, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

*Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimetteknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti i fushës,anëtar i njësisë së prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumentave të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën 26/07/2024*

**Njësia e Prokurimit**